



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 214 Prot.

Tiranë, më 07. 02. 2018

V E N D I M

Nr. 42, Datë 07. 02. 2018

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa numër 110, datë 08.08.2017, e bërë nga një grup¹ personash kundër Bashkisë Korçë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të racës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Ankuesit sqarojnë se: *“Jemi një grup banorësh që jetojmë te konvikti i ish-Bujqësores. Më parë kemi qënë tek Poligoni. Për arsye të ndërtimeve urbanistike jemi larguar prej aty. Nga ana e Bashkisë Korçë na është ofruar një prej Programeve të Strehimit Social, ai i subvencionimit të qirasë, por duke qënë se jemi komunitet rom/egjiptian nuk na japin banesa me qera. Në konviktin e ish-Bujqësores aktualisht banojnë 34 familje, rreth 5-6 familje në përbërje të tyre kanë jo më pak se 6 persona. Secila nga familjet e strehuara ka nga një dhomë konvikti për të jetuar, si dhe një tualet të përbashkët për 5 familje.”*

Në përfundim, ankuesit kërkojnë që:

- T’i largojnë nga konvikti i ish-Bujqësores dhe t’i strehojnë në një ambient më të madh.
- Të kenë nga një tualet të veçantë për secilën familje.
- T’u ofrohen banesa sociale nga Bashkia Korçë, jo vetëm bonusi i subvencionimit të qerasë.

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se ankuesit nuk kishin evidentuar situatën diskriminuese apo trajtimin e pabarabartë, si dhe nuk kishin dhënë informacion, lidhur me kohën kur ka ndodhur situata diskriminuese dhe kur janë vënë në dijeni për të.

¹ M. G.; K. M.; Xh. T.; G. G.; E. LL.; V. G.

Në këto kushte, Komisioneri iu drejtua ankuesëve me anë të email-it, datë 16.08.2017, ku për efekt të shqyrtimit të ankesës së depozituar prej tyre, i kërkohej informacion plotësues mbi:

- Kohën kur ankuesit kanë aplikuar për bonusin e qirasë pranë Bashkisë Korçë. Kopje të kërkesave dhe përgjigjeve të tyre.
- Rast konkret kur i është refuzuar dhënia e banesave me qira.
- A kanë aplikuar për programe të tjera strehimi pranë Bashkisë Korçë. Nëse po, kohën kur kanë aplikuar dhe kopje të kërkesave dhe përgjigjes së marrë nga ana e Bashkisë.
- A i është aprovuar nga ana e Bashkisë, bonusi i qirasë për këto familje. (Ndonjë dokument për të vertetuar këtë)
- Arsyeën pse i ka trajtuar Bashkia në mënyrë të pabarabartë këto familje, në raport me familje të tjera.
- A i janë parashtruar Bashkisë Korçë, pretendimet e ngritura në ankesën e depozituar pranë Komisionerit. Nëse po, kopje të kërkesave apo përgjigjeve të marra.
- Informacion për sa i përket kohës kur ka ndodhur diskriminimi dhe kohës kur kanë marrë dijani për diskriminimin e pretenduar.

Në përgjigje të e-mailit të Komisionerit, ankuesit vunë në dispozicion informacionin e mëposhtëm:

- Nga ana e Bashkisë Korçë, ankuesve në vitin 2016 i është ofruar bonusi i qirasë, por asnjë prej tyre nuk ka arritur të përfitojë pasi nuk kanë mundur të gjejnë banesë me qira, pavarësisht se sipas tyre bashkia ka qënë e gatshme për t'i mbështetur.

Gjithashtu, në përgjigje të kërkesave të Komisionerit, u vu në dispozicion vetëm kopje e kërkesave të një prej ankuesve², ndërsa ankuesit e tjerë nuk kishin asnjë nga dokumentat e kërkuara.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndërmori hapat procedural si më poshtë vijojnë :

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vijoi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me anë të shkresës nr. 816/1 prot., datë 31.08.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, iu drejtua Institucionit të Bashkisë Korçë, në të cilën kërkoi informacion mbi pretendimet e ankuesve.

- Në mbështetje të pretendimeve të ankuesve, Bashkia Korçë, nëpërmjet shkresës³ nr. 3900/1 prot., datë 04.09.2017, informoi KMD-në se: “...Nisur nga zbatimi i dy projekteve me

² Vetëm K. M., vuri në dispozicion të KMD-së kopje të aplikimeve që ka bërë në vitet 2009; 2011; 2014

interes publik si: “Rijetësimi i Pazarit të Vjetër” dhe “Kompleksi Sportiv Sport Planet Korçë”, është ndërhyrë nga ana e institucionit të Bashkisë Korçë, për sistemimin me banesë të rreth 50 familjeve të cilat prekeshin nga këto projekte. Bëhet fjalë për disa banesa tek Pazari i Vjetër dhe ish-Poligoni tek zona e Kompleksit Sportiv. Të dyja këto grup banesash, kanë qënë prej kohësh problematike për shkak të kushteve të papërshtatshme të banimit, shkallës së lartë të amortizimit dhe mungesës totale të mirëmbajtjes nga ana e banorëve. Në këto kushte, u mundësua nga ana e Bashkisë Korçë, lirimi i një konvikti të saporikonstruktuar në favor të banorëve të këtyre zonave, duke lejuar edhe përshtatjen e ambjentëve sipas kushteve të banimit dhe me një kosto shtesë që do të krijohet në të ardhmen rikonstruksioni i kësaj godine. Nga kushtet e reja që kanë gjetur tek kjo godinë, banorët kanë qënë shumë të kënaqur, por kanë të drejtën e tyre për të kërkuar kushte edhe më të përshtatshme. Përveç bonusit të strehimit, me financim të Entit Kombëtar të Banesave, janë në ndërtim dy pallate nga projekti i banesave me kosto të ulët. Me përcaktimin e kriterëve të përfitimit të gjithë të pastrehët edhe këta qytetarë, nëse përmbushin kriteret e parashikuara në Ligjin Nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, kreu V, neni 18 dhe 19, mund të aplikojnë për përfitimin e një banese. Përsa i përket kërkesës së çdo personi për strehim, procedura është e tillë: Familjet aplikojnë sipas kriterëve të parashikuara në ligjin e mësipërm, si dhe të pastreha dhe rregjistruhen pranë Zyrës së Strehimit në Rregjistrin e të Pastrehëve. Kjo është faza e parë e aplikimit. Në fazën e dytë, për çdo projekt që kemi në zbatim, sipas kriterëve të projektit, kategoritë që përshtaten me këto kritere, vazhdojnë plotësimin e dokumentacionit të kësaj faze. Sipas të dhënave për gjëndjen ekonomike të shumicës së familjeve të mësipërme, kemi konstatuar që do të jetë e vështirë të jenë përfituese të këtij projekti, bazuar në kriteret që parashikon ligji. Nisur nga ky fakt, kemi parashikuar zbatim të një projekti me banesa me qera sociale në një nga zonat në periferi të qytetit, zona e ish-traverbankut. Bëhet fjalë për ndërtimin e rreth 120 banesave me dy kate, ekonomikisht të mundshme për të gjithë këta banorë, por edhe për të tjera familje në nevojë. Përsa i përket ecurisë së projektit, ne kemi mbaruar fazën studimore dhe projektuese dhe e kemi paraqitur pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban me kërkesën e tyre për sigurimin e financimit të projektit. Në rast miratimi, do të ishte një zgjidhje optimale, jo vetëm për këto familje, por edhe për të tjera në vështirësi ekonomike.”

2. Përsa më lart, mbështetur në Urdhërin nr. 121, datë 05.10.2017 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi “Për kryerjen e inspektimit pranë Ish-konviktit të Bujqësorës Korçë, me qëllim marrjen e informacionit, lidhur me ankesën nr. 110 rregj., datë 08.08.2017, me ankues: M. G., K. M., Xh. T., G. G., E. Ll. dhe V. G.”, më datë 12.10.2017, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë Bashkisë Korçë, për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

³ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 816/2 prot., datë 11.09.2017

Gjatë inspektimit pranë Bashkisë Korçë, inspektorët e KMD-së, morën takim me ankuesit pranë ambjenteve të banimit në ish-konviktin e Bujqësorës Korçë. Në vijim të inspektimit dhe takimit me ankuesit⁴, inspektorët u informuan se në katin e dytë të godinës së ish-konviktit të Bujqësorës ishin vendosur rreth 15 familje të shpërngulura nga zona e ish-traverbankut. U evidentua se godina ishte rikonstruktuar dhe përshtatur për këto familje. Për këto familje ishin ndërtuar 8 (tetë) tualete të përbashkëta, por vetëm 4 (katër) prej tyre ishin funksionale, pasi 4 (katër) të tjerat ishin të bllokuara me materiale nga vetë banorët. Pavarësisht faktit që godina ishte e restauruar, në disa prej ambjenteve të banimit kishte lagështirë. Sipas banorëve, kushtet e jetesës në këtë ndërtesë janë më të mira se në ambjentet e ish-Polygonit ku kanë jetuar më parë, por hapsirat dhe tualetet ishin të pamjaftueshme për numrin e familjeve që ishin vendosur në ato ambjente.

Një pjesë e banorëve kërkonin nga ana e Bashkisë Korçë që tu jepej mundësia për të përfituar nga programi banesave me kosto të ulët, por nuk dispononin asnjë dokumentacion për të vërtetuar se kishin aplikuar pranë këtij institucioni për këtë program strehimi. Vetëm K. M., sipas dokumentacionit të administruar kishte aplikuar pranë Bashkisë Korçë si e pastrehë së fundmi në vitin 2013, por që nuk kishte përfituar nga programet e strehimit.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Mbështetur në provat e administruara nga të dy palët, rezultoi se:

Në mbështetje të provave të grumbulluara, rezultoi se në muajin Tetor 2016, pas rikonstruksionit të godinës së ish-konviktit të Bujqësorës, familjet e subjekteve ankues janë vendosur në këtë godinë për një periudhë të përkohshme. Fillimisht banorët kanë qënë të kënaqur me këtë zgjidhje, por me kalimin e kohës kanë lindur disa pakënaqësi lidhur me kushtet e godinës dhe hapsirat e saj.

Bashkia Korçë gjatë vitit 2017, pasi ka hartuar projektin, zgjedhur truallin dhe lejen e ndërtimit, ka aplikuar pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban për ndërtimin e një blloku banesash për komunitetin rom/egjiptian të qytetit të Korçës. Sipas informacionit të administruar, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, pranë Bashkisë Korçë, për periudhën 2017-2018-2019, ka përcaktuar prioritetet e investimeve, ku evidentohet se një prej tyre është ndërtimi i banesave për komunitetin rom dhe egjiptian.

Pavarësisht mundësive që u janë krijuar familjeve të vendosura në godinën e ish-konviktit të Bujqësorës, kushtet e ndërtesës dhe hapsirat nuk janë të mjaftueshme për numrin e familjeve të vendosura në të.

Përsa më lart dhe duke marrë shkas nga ankesa e bërë nga ankuesit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi legjislacionin në fuqi, lidhur me programet e strehimit dhe konstatoi se:

⁴ M. G.; K. M.; Xh. T.; G. G.; E. Ll.; V. G.

Ligji Nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për Programet Sociale të Strehimit”, i ndryshuar, në nenin 5, ku përcaktohen kriteret e përzgjedhjes së përfituesve nga programet sociale, parashikon se:

“1. Përzgjedhja e familjeve përfituese bëhet sipas një sistemi pikëzimi, me anë të të cilit vlerësohen:

- a) Kushtet e strehimit, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që:
 - i) nuk disponojnë banesë në pronësi;
 - ii) banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje
 - iii) banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;
 - iv) kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore ose zbatimit të një vendimi gjyqësor.
 - b) Kushtet familjare, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi rastet e mëposhtme:
 - i) familjet njëprindërore, që kanë në ngarkim fëmijë;
 - ii) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;
 - iii) familjet me më shumë se katër fëmijë;
 - iv) çiftet e reja me moshë totale deri në 60 vjeç.
 - c) Kushtet sociale, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi rastet e mëposhtme:
 - i) personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategori;
 - ii) personat me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore e deri në moshën 30 vjeç;
 - iii) emigranti i rikthyer, punëtor emigrant;
 - iv) familjet e policëve të rënë në detyrë;
 - v) viktimat e dhunës në familje.
 - ç) Gjendja ekonomike, në bazë të së cilës përcaktohen familjet sipas grupeve të të ardhurave.
2. Sistemi i pikëzimit miratohet me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore për çdo program që zbatohet në një njësi të qeverisjes vendore dhe bazohet në kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.
3. Kur programi zbatohet me financim, të plotë ose të pjesshëm, të Buxhetit të Shtetit, ministria, që mbulon çështjet e strehimit, në raport me masën e financimit dhe në bashkërendim dhe në marrëveshje me kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore përkatëse, mund të kushtëzojë një sistem pikëzimi, që favorizon kategori, të cilat kanë përparësi në politikat kombëtare, si personat me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore deri në moshën 30 vjeç, personat me aftësi të kufizuara, punëtorët emigrantë, emigrantët e rikthyer, familjet e policëve të rënë në detyrë. Marrëveshja, përveç sistemit të pikëzimit, për kategoritë e sipërpërmendura, përfshin edhe angazhimin për mbulimin e shpenzimeve, sipas pikës 2 të nenit 24 të këtij ligji.
4. Në objektet e reja që ndërtohen, organet e qeverisjes vendore, në përzgjedhjen e përfituesve marrin parasysh si kriter edhe përzierjen e grupeve të ndryshme sociale, me qëllim që të shmanget veçimi social.”

Në nenin 24, të ligjit të sipërcituar parashikohet se: “2. Përparësi në subvencionimin e qirasë ose përfitimin e bonusit të strehimit kanë kategoritë e mëposhtme: a) personat me statusin e jetimit; b) personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategori; c) familjet e policëve të rënë në detyrë. ç) emigrantët e rikthyer; d) punëtori emigrant; dh) familjet e komunitetit rom; e) punonjësit e Policisë së Shtetit.”

Përsa më lart, programet sociale strehimi janë “programe, të cilat shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve, që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave. Në të përcaktohen tre programe sociale strehimi: banesat sociale me qira, banesat me kosto të ulët dhe programi i pajisjes së truallit me infrastrukturë. Përfituesit e programeve sociale të strehimit duhet të përmbushin njërin prej kritereve të mëposhtme: nuk kanë në pronësi një banesë; zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit; ose kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore (Ligji nr. 9232, neni 4). Përzgjedhja e përfituesve mbështetet tek kushtet e tyre të jetesës si edhe tek rrethanat e tyre shoqërore dhe ekonomike. Përparësi u jepet 15 grupeve, përfshirë familjet me një prind të vetëm, familjet e mëdha, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, çiftet e reja, familjet që kanë ndryshuar vendqëndrim, jetimët, emigrantët e rikthyer, punëtorët migrues, azilkërkuesit, oficerët e rënë në detyrë, viktimat e dhunës në familje, familjet rome, familjet egjiptiane dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.

Në të njëjtën frymë qëndron edhe VKM-ja Nr. 1093, datë 28.12.2015 “Për miratimin e procedurave, kritereve dhe përparësive për dhënien e bonusit të strehimit”, në të cilën i jepet përparësi të njëjtës kategori të familjeve përfituese.

Refruar politikave të hatuara nga qeveria dhe Bashkia Korçë, shihet që për familjet e vendosura në në godinën e ish-konviktit të Bujqësore apo edhe për familje të tjera të komunitetit rom/egjiptian të qytetit të Korçës, është planifikuar projekti për ndërtimin e banesave dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për këto komunitete. Nga ana e Institucionit të Bashkisë Korçë janë duke u ndërmarrë të gjitha masat për përmirësimin e kushteve të jetesës së familjeve të komunitetit rom/egjiptian, duke përcaktuar si prioritetet të investimeve gjatë 2 viteve në vijim, ndërtimin e një blloku banesash për komunitetin rom/egjiptian. Në këtë mënyrë, është vendosur që çështjes sensitive të strehimit të familjeve në nevojë, të qytetit të Korçës t’i jepet një zgjidhje afatgjatë.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7, pika 1⁵, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri gjykon se, vendosja e përkohshme e familjeve të komunitetit rom/egjiptian në godinën e konviktit të ish-Bujqësore, nuk i ka ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë për shkak të racës.

⁵ Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjekteve ankuese, M. G., K. M., Xh. T., G. G., E. LL. dhe V. G., për shkak të racës nga ana e Bashkisë Korçë.
2. Me qëllim parandalimin e situatave që mund të rrezikojnë jetën apo shëndetin e tyre, rekomandojmë Bashkinë Korçë, për marrjen e masave për mirëmbajtjen e godinës së ish-Konviktit të Bujqësorës Korçë, deri në momentin që për banorët e vendosur në të, të gjendet zgjidhja përfundimtare e strehimit.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

KOMISIONERI

Irma BARAKU

(Shkaku: Raca)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)